

Asociacioni i Komunave Serbe në limbon e marrëveshjeve të papërbushura

Maj
2022





1.

Asociacioni i Komunave Serbe në Limbon e Marrëveshjeve të Papërmbyshura

2.

Loja e numrave: Zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur 20 vjet më vonë

3.

Një tjetër mollë sherri: KOS në Dialogun për Normalizimin e marrëdhënies

4.

Furnizimi me energji elektrike në veri të Kosovës

5.

Privatizimi në Kosovë nga këndvështrimi i komunitetit Serb

6.

Liria e lëvizjes: Episoda stiker

Titulli i hulumtimit: Asociacioni i Komunave Serbe
në Limbon e Marrëveshjeve të Papërbushura

Botues: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
– KFOS

Për botuesin: Forumi për Zhvillim dhe
Bashkëpunim Multietnik – FDMC

Autorët: Boban Simiq – FDMC

Ky dokument fillimisht është shkruar në gjuhën
serbe

Përkthyes: Qerim Ondozi

Dizajn: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): 80

Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit
OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës
për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim
me Forumin për Zhvillim dhe Bashkëpunim
Multietnik - FDMC. Qëndrimet e shprehura në
këtë publikim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht qëndrimet e KFOS-it.

Viti i publikimit: Maj 2022

PËRMBAJTJA

01.

Rreth Nismës Open 7

HYRJE 8

02.

METODOLOGJIA 9

Dizajni i hulumtimit cilësor 11

03.

ASOCIACIONI I
KOMUNAVE SERBE
DHE DIALOGU I
BEOGRADIT DHE
PRISHTINËS 12

Marrëveshja e Brukselit
dhe "ujdia e madhe" 12

Parimet e përgjithshme
dhe vendi i Gjykatës
Kushtetuese 13

Fati i paqartë i
Asociacionit të Komunave
serbe 14

04.

MOSPAJTIMI RRETH
KOMPETENCAVE TË
ASOCIACIONIT TË
KOMUNAVE SERBE 17

05.

ASOCIACIONI
I KOMUNAVE
SERBE DHE POZITA
E SERBËVE TË
KOSOVËS 20

06.

SHTJELLIMET
PËRFUNDIMTARE 24

07.

REKOMANDIME 27

Rreth Nismës Open

“Demokracia, haptësia dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë – OPEN” është nismë e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), që ka filluar gjatë vitit 2020. Kjo nismë ka për qëllim të zhvillojë hapësirë të hapur e dinamike për diskutime brenda dhe mes komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera si dhe me institucionet e Kosovës.

Organizatave të shoqërisë civile nga komuniteti serb në Kosovë, anëtare të nismës, merren specifikisht me analiza dhe vlerësime të ndikimit të organizatave civile e politike në zhvillimin e demokracisë, si dhe në haptësinë e komunitetit serb në Kosovë. Me këto analiza vlerësohet haptësia e institucioneve, politikave publike dhe proceseve të rëndësishme karshi komunitetit serb në Kosovë, si dhe niveli i haptësisë së komunitetit serb karshi tyre.

Këto analiza do të ndihmojnë të pasqyrohet gjendja aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, duke shërbyer njëkohësisht edhe si bazë për përfaqësimin e argumentuar të orientuar drejt vendimmarrësve, institucioneve të pushtetit lokal e qendror, si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

1. Hyrje

Asociacioni i Komunave Serbe tash e një dekadë përbën çështjen më kundërthënëse të dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës i cili po zhvillohet nën ombrellën e Bashkimit Evropian. Arsyeja që e bën këtë çështje kaq të diskutueshme është fakti se Asociacioni i Komunave Serbe nuk është themeluar përkundër marrëveshjes së arritur dhe zotimeve të dhëna. Ndryshe nga çështjet tjera për të cilat nuk shihet zgjidhje kompromisi, për shkak të qëndrimeve të papajtueshme mes Beogradit dhe Prishtinës, marrëveshja e palëve për formimin e Asociacionit të Komunave Serbe u konfirmua përmes dy marrëveshjeve të nënshkruara në vitin 2013 dhe 2015.

Dialogu ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës u fut në një gjendje të stërzgjatur ngërçi në momentin kur duhej të fillonin negociatat për një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve, si rezultat përfundimtar i procesit të Brukselit. Asociacioni i Komunave Serbe paraqet shkas për akuza të rënda nga të dyja palët, duke e bërë të pakuptimtë vazhdimin e dialogut. Por, retorika e ekzagjruar politike që po dëgjohet tregon pak respekt për pozitën e serbëve të Kosovës, për të mirën e të cilëve duhet të formohet Asociacioni i Komunave Serbe.

Përkundër faktit se dialogu është në qorrsokak, Beogradi dhe Prishtina nuk tregojnë gatishmëri, nuk punojnë për formimin e Asociacionit dhe as nuk përpiqen t'i zgjidhin me bisedime keqkuptimet që pengojnë formimin e tij. Për të dhënë një rrugëdalje të mundshme nga pozita

pat, ky punim synon të qartësojë vendin që Asociacioni i Komunave Serbe zë në dialogun Beograd-Prishtinë, por edhe të tregojë rolin që mund të luajë ky Asociacion në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të komunitetit serb të Kosovës.

Vështrimi i Asociacionit të Komunave Serbe kryesisht nga pikëpamja e procesit më të gjerë negociues, çon në humbjen e rëndësisë që mund të ketë ai për përmirësimin e pozitës së serbëve në Kosovë. Debatit publik për këtë çështje i mungojnë njohuritë mbi nevojat dhe interesat e serbëve të Kosovës, të cilëve Asociacioni duhet t'u shërbejë në radhë të parë. Prandaj, ky punim synon të shtjellojë se si Asociacioni mund t'i kontribojë plotësisht të boshllëqeve në kornizën institucionale për mbrojtjen e të drejtave të serbëve në Kosovë.

Pikënisje për hartimin e këtij punimi janë gjetjet e hulumtimit mbi qëndrimet dhe perceptimet e komunitetit serb në Kosovë, i cili është realizuar në kuadër të programit Open. Në këtë punim vihet theksi mbi Asociacionin e Komunave Serbe si mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të serbëve në Kosovë, në përputhje me zotimet e dhëna, dhe avokon qëndrim për t'i hapur rrugë një marrëveshjeje mes Beogradit dhe Prishtinës për formimin e tij, si dhe për të mundësuar rifillimin e dialogut.

2. Metodologjia

Këtij punimi i ka paraprirë një studim empirik me qëllim të njohjes së qëndrimeve dhe perceptimeve të pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë lidhur me Asociacionin e Komunave Serbe. Si teknika për grumbullimin e të dhënave janë përdorur intervistat e thelluara, grupet e fokusit dhe sondazhi.


Hulumtimi në terren sy më sy është realizuar në periudhën tetor-nëntor të vitit 2021, me një mostër prej 500 respondentësh nga komuniteti serb. Pyetësori përmbante 46 pyetje dhe shtjellonte gjithsej 6 fusha. Mostra ishte

e qëllimshme, kuotuese, ndërsa kriteri për përcaktimin e kuotës ishte madhësia e komunës së banimit. Intervali i besimit përmban +/-5. Në mostër ishin gjithsej 60.2% meshkuj dhe 39.8% femra. Moshë mesatare e respondentëve ishte 42 vjeç. Në veri të lumit Ibër janë anketuar 64% të respondentëve, derisa në jug të lumit Ibër janë anketuar 36% të respondentëve. Anketa ka mbuluar respondentë nga komunat Leposaviq, Zveçan, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Graçanicë, Shtërpcë, Novobërdë, Ranillug, Kllokot, Partesh-Pasjane, dhjetë komuna me shumicë serbe, dhe Kamenicë.

Hulumtimi në terren sy më sy është realizuar në periudhën tetor-nëntor të vitit 2021, me një mostër prej


500

respondentësh nga komuniteti serb.



Në veri të lumit Ibër janë anketuar

64% të respondentëve,



derisa në jug të lumit Ibër janë anketuar

36% të respondentëve.

Anketa ka mbuluar respondentë nga komunat Leposaviq, Zveçan, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Graçanicë, Shtërpcë, Novobërdë, Ranillug, Kllokot, Partesh-Pasjane, dhjetë komuna me shumicë serbe, dhe Kamenicë.

Në mostër ishin gjithsej

60.2%



39.8%



Moshë mesatare e respondentëve ishte **42 vjeç.**

Intervali i besimit përmban +/-5.

KOMUNA:	FREKUENCA:	PËRQINDJA:	PËRQINDJA E VLEFISHME:	PËRQINDJA KUMULATIVE:
Leposaviq	110	22.0	22.0	22.0
<hr/>				
Kamenicë	10	2.0	2.0	24.0
<hr/>				
Novobërdë	30	6.0	6.0	30.0
<hr/>				
Zubin Potok	50	10.0	10.0	40.0
<hr/>				
Shtërpçë	30	6.0	6.0	46.0
<hr/>				
Zveçan	60	12.0	12.0	58.0
<hr/>				
E vlefshme:	<hr/>			
Graçanicë	60	12.0	12.0	70.0
<hr/>				
Ranillug	30	6.0	6.0	76.0
<hr/>				
Partesh	10	2.0	2.0	78.0
<hr/>				
Kllokot	10	2.0	2.0	
<hr/>				
Mitrovica e Veriut	100	20.0	20.0	100.0
<hr/>				
Total:	500	100.0	100.0	

Në kuadër të hulumtimit janë realizuar gjithsej pesë intervista të thelluara me përfaqësues të shquar të komunitetit serb në Kosovë. Intervistat janë zhvilluar me nga një bashkëbisedues nga Graçanica, Shillova, Osojane dhe me dy bashkëbisedues nga Mitrovica e Veriut. Janë organizuar edhe katër grupe fokusi me banorët e

Graçanicës, Shtërpcës, Mitrovicës së Veriut dhe Anamoravës (komunat e Ranillugut, Novobërdës dhe Parteshit). Përveç kësaj, ky punim u bazua në njohuri dhe informata të mbledhura përmes analizës së dokumenteve dhe raporteve të mediave.

Dizajni i hulumtimit cilësor

GRUPET E FOKUSIT

Periudha:

Hulumtimi i realizuar nga
1.10.2021 – 31.01.2022

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzues për bisedë
me 10 pyetje

Numri i grupeve të fokusit:

4 grupe të fokusit

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve:

24 pjesëmarrës

Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve:

vendbanimi, niveli
arsimor, gjinia, moshja
dhe profesioni

INTERVISTAT

Periudha:

Hulumtimi i realizuar nga
1.10.2021 – 31.01.2022

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzues për bisedë
me 6 pyetje

Numri total i të intervistuarve:

5 të intervistuar

Kriteri për zgjedhjen e bashkëbiseduesve:

Pjesëmarrja në jetën
shoqëro-politike të
komunitetit serb në
Kosovë, vendbanimi

3. Asociacioni i Komunave Serbe dhe dialogu i Beogradit dhe Prishtinës

Marrëveshja e Brukselit dhe “ujdia e madhe”

Asociacioni i Komunave Serbe është futur në dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës përmes “Marrëveshjes së Parë mbi Parimet që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve” (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja e Brukselit), të cilën në prill të vitit 2013 në Bruksel e nënshkruan kryeministrat e atëhershëm të Serbisë dhe Kosovës, Ivica Dačić dhe Hashim Thaçi¹. Formimi i Asociacionit ishte pjesë e “ujdisë së madhe” të arritur mes Beogradit dhe Prishtinës në atë kohë. Prishtina pranoi formimin e Asociacionit të Komunave Serbe në këmbim të pëlqimit të Beogradit për shfuqizimin e “institucioneve paralele” në veri të Kosovës, gjegjësisht integrimin e strukturave policore, gjyqësore dhe komunale nga katër komunat veriore në sistemin e unifikuar institucional të Kosovës.

Deri më sot, Marrëveshja e Brukselit konsiderohet si rezultati më i madh i dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës, të zhvilluar nën ombrellën e Bashkimit Evropian për më shumë

se një dekadë. Rëndësia e Marrëveshjes së Brukselit reflektohet jo vetëm në ndjeshmërinë politike të çështjeve për të cilat ajo ka gjetur zgjidhje të pranueshme dypalëshe, por edhe për faktin se është bërë progres i “prekshëm” në zbatimin e saj. Çështje e vërteta, një pjesë e madhe e Marrëveshjes së Brukselit vërtet është jetësuar në praktikë. Pavarësisht vonesave të herëpashershme, pala serbe i ka përmbushur obligimet e veta. Por, Asociacioni i Komunave Serbe ende nuk është formuar.

Rëndësia e çështjes së Asociacionit të Komunave Serbe në Marrëveshjen e Brukselit vërtetohet me faktin se ky dokument fillon me dispozitën për themelimin e Asociacionit dhe i kushton 6 nga 15 pikat e tij. Marrëveshja parasheh se do të ekzistojë “Asociacioni/ Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë” dhe se do të formohet në bazë të një Statuti i cili do të thirret në Statutin ekzistues të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Komunitet do të bashkëpunojnë në ushtrimin kolektiv të kompetencave të tyre përmes Asociacionit, i cili do të “ushtrijë mbikëqyrje të plotë” në fushat e zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, zhvillimit urban dhe rural. Komuniteti mund të ushtrijë gjithashtu kompetenca shtesë që mund t’i besohen nga autoritetet qendrore, dhe mund

¹ “Marrëveshja e parë mbi parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve”, Zyra për Kosovë dhe Metohi, <http://www.kim.gov.rs/lat/p03.php>

të ketë rol përfaqësues përballë autoriteteve qendrore dhe një vend në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve².

Baza për formimin e Asociacionit gjendet edhe në Planin e Ahtisaarit, të cilin Kosova në mënyrë të njëanshme është zotuar ta zbatojë dhe të cilin e ka inkuorporuar në Kushtetutën e saj. Plani i Ahtisaarit në decentralizimin e gjerë ka gjetur një mekanizëm për të mbrojtur interesat legjitime të serbëve dhe komuniteteve të tjera joshumicë në Kosovë. Ndër të tjera, plani parashihte formimin e një numri komunash me shumicë serbe dhe vërtetoi të drejtën e tyre për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar për çështjet me interes të përbashkët, si dhe të drejtën e komunave për të bashkëpunuar me institucionet nga Serbia dhe të marrin ndihmë financiare nga Serbia³.

Marrëveshja për formimin e Asociacionit të Komunave Serbe në fakt ishte një aktualizim i dispozitave të Planit të Ahtisaarit. Në kontekstin e Marrëveshjes së Brukselit, krijimi i Asociacionit kishte për qëllim lehtësimin e krijimit të komunave të reja në veri dhe integrimin e tyre në sistemin e Kosovës. Edhe pse komunitat e reja u themeluan, Asociacioni nuk u formua. Shtoja kësaj edhe faktin se pala serbe ka zbatuar pjesën e saj të Marrëveshjes së Brukselit, ndërsa në të njëjtën kohë nuk ka kërkuar që Prishtina reciprokisht t'i përmbushë obligimet e saj në lidhje me formimin e Asociacionit. Kësajori i është lënë mundësia Prishtinës që në rrjedhën e mëtuqjeshme të dialogut ta shfrytëzojë formimin e Asociacionit të Komunave Serbe si adut që mund ta ofrojë sërish në këmbim të lëshimeve të reja nga pala serbe. Kjo edhe ndodhi në vitin 2015, kur Asociacioni u bë pjesë e një pakete të re marrëveshjesh që përfshinte marrëveshjet për energjinë, telekomunikacionin dhe urën e lbrit.

2 ibid.

3 Plani i Ahtisaarit, KOSSEV, <https://kossev.info/wp-content/uploads/public/dokumenti/Sveobuhvatni%20predlog%20Martija%20Ahtisaarja.pdf>

Parimet e Përgjithshme dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese

Në gusht të vitit 2015 kryeministrat e atëhershëm të Serbisë dhe Kosovës, Aleksandar Vuçiq dhe Isa Mustafa, arritën marrëveshjen me titull "Asociacioni/Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë – Parimet e Përgjithshme/Elementet kryesore" (në tekstin e mëtejshëm: Parimet e Përgjithshme). Ky dokument vërtetoi se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të themelohej në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Brukselit. Asociacioni do të definohej me Statutin e tij, i cili do të miratohet nga një kuvend themelues i përbërë nga përfaqësues të kuvendeve të komunave anëtare, dhe Qeveria e Kosovës do të miratojë një Dekret me të cilin do të konfirmohet Statuti dhe të cilin do ta shqyrtojë Gjykata Kushtetuese⁴.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës lidhur me çështjen e Asociacionit të Komunave Serbe u deklarua në dhjetor të vitit 2015, në aktgjykimin lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së Parimeve të Përgjithshme me frymën e Kushtetutës së Kosovës. Vendimi është marrë në bazë të iniciativës të cilën në tetor të vitit 2015 e ndërmori Presidentja e atëhershme e Kosovës, Atifete Jahjaga⁵.

Duke analizuar Parimet e Përgjithshme, kapitull për kapitull, Gjykata Kushtetuese konstatoi se ky dokument është akt juridik që duhet të mundësojë zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit si marrëveshje ndërkombëtare. Në të vërtetë, meqë Kuvendi i Kosovës në qershor të vitit 2013 miratoi Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Brukselit, ai u bë pjesë e sistemit të brendshëm juridik të Kosovës si marrëveshje e ratifikuar ndërkombëtare. Siç konstatoi Gjykata

4 "Asociacioni / Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë - Dispozitat e Përgjithshme / Elementet Kryesore", Zyra për Kosovë dhe Metohi, <http://www.kim.gov.rs/pl7.php>.

5 "Aktgjykimi", Gjykata Kushtetuese, <https://gjk-ks.org/sr/decision/u-vezi-sa-ocenom-saglasnosti-principa-sadranih-u-dokumentu-pod-nazivomasocijacijazajednica-optina-sa-spskom-ve263inom-në-kosovë-opti-principiglavni-elementi/>.

Kushtetuese, Marrëveshja e Brukselit nuk është e zbatueshme në vetvete, por kërkon legjislacion shtesë për zbatim. Kështu, Gjykata Kushtetuese konkludoi se zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit kërkon themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe që vetvetiu është edhe pjesë e rendit kushtetues të Kosovës⁶.

Në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese thuhet se Asociacioni i Komunave Serbe do të themelohet sipas planit, gjegjësisht se Qeveria e Kosovës do të miratojë një Dekret të zbatueshëm drejtpërdrejt, i cili mund të inkorporojë Statutin e Asociacionit dhe se i gjithë akti do t'i dorëzohet Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Parimet e Përgjithshme nuk ishin plotësisht në përputhje me frymën e Kushtetutës, gjegjësisht se një numër i madh i dispozitave të këtij dokumenti "nuk i përmbushin plotësisht standardet kushtetuese". Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese ka vendosur që akti juridik i Qeverisë dhe Statuti i Asociacionit të Komunave Serbe duhet t'i plotësojnë standardet kushtetuese dhe të jenë në përputhje me Kushtetutën⁷.

Fati i paqartë i Asociacionit të Komunave Serbe

Ekipi drejtues për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe u prezantua në shtator të vitit 2016 në Bruksel. Ekipi drejtues prej katër anëtarësh është emëruar nga autoritetet e Prishtinës me detyrën që, pa vonesë, të fillojë puna për hartimin e Statutit të Asociacionit të Komunave Serbe⁸. Ndonëse pati njoftime që deri më 4 gusht të vitit 2018 ekipi drejtues do të paraqiste Projektstatutin në Bruksel, ai kurrë nuk e pa dritën e ditës⁹. Në vend të kësaj,

6 ibid.

7 ibid.

8 "Ekipi për themelimin e AKS-së", Danas, <https://www.danas.rs/vesti/politika/tim-za-uspostavljanje-zso/>.

9 "Statuti i Asociacionit të Komunave Serbe gati për Bruksel", Evropa e Lirë, <https://www.slobodnaevropa.org/a/statut-zajednice-op%C5%Altina-spreman-za-brisel/29409651.html>.

në diskursin publik në atë kohë u fut ideja e "delimitimit" si zgjidhje potenciale, e cila nuk dukej e pajtueshme me formimin e Asociacionit të Komunave Serbe¹⁰.

Marrëdhënia që Prishtina zyrtare pas vitit 2018 e kishte karshi Asociacionit të Komunave Serbe, varionte nga pranimi në parim i detyrimit për formimin e tij, me përpjekjet për ta shtyrë dhe lidhur me nënshkrimin e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për normalizimin dhe, mbase, njohjen nga Serbia, e deri në refuzimin e plotë të zotimeve në lidhje me formimin e Asociacionit¹¹. Qeverisja aktuale në Prishtinë, e cila që nga viti 2021 udhëhiqet nga Presidentja e Kosovës Vjosa Osmani dhe Kryeministri Albin Kurti, ka mbajtur qëndrimin e refuzimit eksplicit ndaj formimit të Asociacionit të Komunave Serbe, në përputhje me narrativën për "Republika Srpska", formimi i të cilit gjoja do t'i bënte institucionet e Kosovës jofunkionale¹².

Formimi i Asociacionit të Komunave Serbe për Beogradin është kusht për vazhdimin e dialogut¹³. Gjatë vizitave në Beograd dhe Prishtinë të cilat në fillim të vitit 2022 i realizuan bashkërisht i Dërguari i Posaçëm i OKB-së për Ballkanin Perëndimor Gabriel Escobar dhe Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian për Dialog, Miroslav Lajçak, u rikonfirmua përkushtimi për të respektuar të gjitha marrëveshjet e arritura më parë, përfshirë marrëveshjen që lidhet me themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe. Me atë rast u la të kuptohet mundësia e diskutimit të modeleve të reja për formimin e Asociacionit të Komunave Serbe për të tejkaluar ngërçin¹⁴.

10 "Vuçiq: Jam për demarkacion me shqiptarët", RTS, <https://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/politika/3224651/vucic-ja-sam-za-razgranicenje-sa-albancima.html>.

11 "Hoti në Bruksel: Do ta formojmë AKS-në, por vetëm pasi të arrijmë marrëveshjen përfundimtare", N1, <https://rs.n1info.com/vesti/a638547-hoti-zso-kad-se-postigne-finalni-dogovor-sa-beogradom/>.

12 "Osmani: Nuk do të lejojmë modele që do ta bënin Kosovën jofunkionale", Al Jazeera Balkans, <https://balkans.aljazeera.net/news/balkan/2022/1/31/osmani-necemo-dozvoliti-modele-koji-bi-kosovo-cinili-nefunkcionalni>.

13 "Petkoviç: Pa formimin e ASK-së nuk mund të ecim përpara", Zyra për Kosovë dhe Metohi, <http://www.kim.gov.rs/v4660.php>.


14 "Escobar dhe Lajçak po përgatisin terrenin për vazhdimin e dialogut pas zgjedhjeve në Serbi", Glas Amerike, <https://www.glasamerike.net/a/srbija-kosovo-eskobar-lajcak-dijalog-brisel-vasington/6422261.html>.

Rezultatet e një sondazhi të realizuar me serbët në Kosovë për qëllime të hartimit të këtij punimi tregojnë se të anketuarit besojnë se formimi i Asociacionit të Komunave Serbe do t'i kontribonte arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse mes Beogradit dhe Prishtinës. 58.4% e të anketuarve pajtohen plotësisht ose pjesërisht me këtë pohim, ndërsa 21.8 nuk kanë përgjigje për këtë pyetje. Rezultati është i paraqitur në Figurën 1.

Ka mendime të ndryshme në mesin e pjesëmarrësve të grupeve të fokusit dhe të intervistuarve nëse arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse do të ishte më afër po që se

do të formohej Asociacioni i Komunave Serbe. Shumica konsideron se Beogradi nuk do të pranojë një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Prishtinën, edhe nëse formohet Asociacioni. Disa nga bashkëbiseduesit besojnë se kjo nuk do të ndodhë sepse ka çështje të tjera që duhet të zgjidhen, ndërsa të tjerët besojnë se Beogradi nuk do ta nënshkruajë marrëveshjen sepse kjo do të nënkuptonte njohje de facto të Kosovës. Disa bashkëbisedues janë të mendimit se këto çështje janë të ndërlidhura, sepse formimi i Asociacionit do të ishte koncesion i Prishtinës që Beogradi do ta pranonte në këmbim të arritjes së marrëveshjes apo njohjes.

Figura 1. A do t'i kontribonte formimi i Asociacionit të Komunave Serbe (AKS) arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse mes Beogradit dhe Prishtinës?




Kur bëhet fjalë për përgjegjësinë për faktin pse Asociacioni i Komunave Serbe ende nuk është formuar, më shumë se gjysma e të anketuarve (50.2%) besojnë se Bashkimi Evropian është më përgjegjës. Pas Bashkimit Evropian vjen Prishtina, të cilën si më përgjegjëse e kanë konsideruar 32.4% e të anketuarve. Rezultati është i paraqitur në Figurën 2.

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit dhe të intervistuarit besojnë se përgjegjësia është e të trija palëve – Prishtinës, Beogradit dhe Bashkimit Evropian. Shumica prej tyre veçojnë Qeverinë e Kosovës, gjegjësisht Prishtinën, e cila, siç theksojnë, refuzon në mënyrë eksplicite

detyrimin për formimin e Asociacionit dhe krijon një atmosferë në të cilën kjo është e pamundur. Të tjerët mendojnë se më përgjegjës është Bashkimi Evropian, i cili ndonëse është garantues i marrëveshjes, nuk i bëri presion Prishtinës për formimin e Asociacionit. Një numër i tyre besojnë se Beogradi është përgjegjës, i cili nuk kërkon sa duhet zbatimin e marrëveshjes nga Prishtina dhe Bashkimi Evropian. Aktorë të tjerë përgjegjës përfshijnë Shtetet e Bashkuara, të cilat nuk kërkojnë nga Prishtina të zbatojë obligimet e saj, si dhe përfaqësuesit politikë serbë të Kosovës, të cilët nuk kërkojnë që Prishtina të formojë Asociacionin në mënyrë adekuate.

Figura 2. Cili nga subjektet e mëposhtme është më përgjegjës për faktin pse Asociacioni i Komunave Serbe (AKS) ende nuk është formuar?



4. Mospajtimi rreth kompetencave të Asociacionit të Komunave Serbe

“Guri pengues” që frenon zbatimin e marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe ka të bëjë me kompetencat që ai do t’i kishte, dhe elementi kryesor i mosmarrëveshjes mes Beogradit dhe Prishtinës është mundësia që Asociacioni të ketë “kompetenca ekzekutive”.

Sipas Parimeve të Përgjithshme, objektivat kryesore të Asociacionit janë “kryerja e funksioneve dhe shërbimeve publike” në lidhje me fusha të caktuara. Gjurmëve të Marrëveshjes së Brukselit, Parimet e Përgjithshme në mesin e funksioneve të Asociacionit parashikojnë “mbikëqyrjen e plotë” në lidhje me: zhvillimin e ekonomisë lokale; fushën e arsimit; përmirësimin e kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor dhe social; koordinimin e zhvillimit urban dhe rural. Gjithashtu, Parimet e Përgjithshme konfirmojnë se Asociacioni do të ketë funksione në fushat e mëposhtme: forcimi i demokracisë lokale; miratimi i masave për përmirësimin e kushteve të jetesës së të kthyerve në Kosovë; promovimin dhe përfaqësimin e çështjeve me interes të përbashkët për komunitet anëtare dhe përfaqësimin e tyre, duke përfshirë edhe përpara

autoriteteve qendrore; formimi i qëndrimeve me interes të përbashkët për pjesëmarrje në punën e autoriteteve qendrore¹⁵.

Siç rrjedh nga marrëveshja, “mbikëqyrja e plotë” nga Asociacioni është e kufizuar në zhvillimin ekonomik, arsimin, shëndetësinë, zhvillimin urban dhe rural. As sipas interpretimit më të gjerë të dispozitave të marrëveshjes, Asociacionit nuk i janë dhënë kompetenca përmes të cilave mund të dëmtojë punën e institucioneve qendrore, sepse këto janë fusha ku qeveria qendrore në Kosovë tashmë ka obligim të respektojë autonominë komunale, në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, zhvillimi ekonomik dhe planifikimi urban dhe rural janë kompetenca burimore të komunave. Ligji gjithashtu përcakton se komunitet e Kosovës me shumicë serbe kanë kompetenca të zgjeruara në shëndetësi, arsim dhe kulturë, duke përfshirë kujdesin për trashëgiminë fetare, si dhe të

¹⁵ “Asociacioni / Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë - Dispozitat e Përgjithshme / Elementet Kryesore”, op. cit.

drejtën për të marrë pjesë në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore. Komunitetet e Mitrovicës së Veriut, Graçanicës dhe Shtërpçës kanë kompetenca të zgjeruara në aspektin e kujdesit shëndetësor sekondar, ndërsa komuna e Mitrovicës së Veriut ka kompetenca të zgjeruara në aspektin e arsimit të lartë. Ligji parashikon gjithashtu se komunitetet kanë të drejtë të krijojnë partneritete për ushtrimin e kompetencave të tyre, si dhe të bashkëpunojnë me institucionet në Serbi, që përfshin mundësinë e marrjes së ndihmës financiare. Përveç vetë komunave, partneritetet mes komunave kanë të drejtë edhe për marrëdhënie të drejtpërdrejta me institucionet në Serbi¹⁶.

Meqë Asociacioni i Komunave Serbe do të ishte partneritet komunal, autonomia që ai do të gëzonte për sa i përket fushave që do t'i jepeshin nuk do të ishte më e madhe se ajo që tashmë gëzojnë komunitetet. Roli i Asociacionit do të ishte të koordinonte përpjekjet e komunave në kryerjen e funksioneve të tyre. Kjo nuk i kufizon kompetencat e institucioneve qendrore për të mbikëqyrur punën e komunave në përputhje me rregulloret. Rezerva që Gjykata Kushtetuese shpalosi në lidhje me kompetencat e Asociacionit të parashikuara në Parimet e Përgjithshme nuk kishte të bënte me marrëdhëniet e institucioneve qendrore me komunitetet. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese shprehu shqetësimin se Asociacioni mund të zëvendësojë ose zvogëlojë statusin e komunave¹⁷.

Për sa i përket marrëdhënieve me autoritetet qendrore, Asociacionit nuk i janë dhënë funksione në fusha në të cilat ato kanë kompetencë ekskluzive, si mbrojtja e sigurisë dhe rendit publik ose politika e jashtme. Sipas marrëveshjeve, Asociacioni i Komunave Serbe do të duhej të ishte platformë për përfaqësimin e interesave të komunitetit serb në nivel qendror. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se Asociacionit nuk mund t'i

¹⁶ "Ligji për Vetëqeverisjen Lokale", <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/10/Zakon-O-Lokalnoj-Samoupravni.pdf>.

¹⁷ "Aktgjykimi", op. cit.




Meqë Asociacioni i Komunave Serbe do të ishte partneritet komunal, autonomia që ai do të gëzonte për sa i përket fushave që do t'i jepeshin nuk do të ishte më e madhe se ajo që tashmë gëzojnë komunitetet.

besohet autoriteti i plotë dhe ekskluziv për të promovuar interesat e komunitetit serb në Kosovë në marrëdhëniet e tij me autoritetet qendrore. Gjykata Kushtetuese konfirmoi të drejtën e Asociacionit për të emëruar përfaqësues në Këshillin Konsultativ për Komunitete. Nga ana tjetër, Gjykata konstatoi se Asociacioni nuk mund të ketë të drejtën për të bërë nisma legjislative, gjegjësisht të drejtën për të propozuar ndryshime dhe plotësime të ligjeve. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese konfirmoi se Asociacioni ka të drejtën e qasjes në gjykata, gjegjësisht të drejtën për të inicuar procedurë para Gjykatës Kushtetuese dhe për të pretenduar se është viktimë e shkeljes së të drejtave të garantuara me Kushtetutë¹⁸.

Marrëdhënia mes Asociacionit të Komunave Serbe dhe institucioneve të Kosovës ka qenë objekt i hulumtimit të kryer për qëllimet e këtij punimi. Sondazhi i realizuar me serbë në Kosovë tregoi se shumica e të anketuarve besojnë se formimi i Asociacionit të Komunave Serbe do të përmirësonte funksionalitetin e institucioneve të Kosovës. 50.8% e të anketuarve besojnë se formimi i Asociacionit do të kishte ndikim shumë pozitiv ose deri diku pozitiv në funksionimin e institucioneve të Kosovës, ndërsa 7.8% e tyre besojnë se do të kishte ndikim deri diku ose shumë negativ. Rezultati është i paraqitur në Figurën 3.

¹⁸ ibid.

Figura 3. Cili nga subjektet e mëposhtme është më përgjegjësi për faktin pse Asociacioni i Komunave Serbe (AKS) ende nuk është formuar?



Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit dhe të intervistuarit gjithashtu besojnë se formimi i Asociacionit të Komunave Serbe nuk mund të rrezikonte aspak funksionimin e institucioneve të Kosovës. Besohet se pretendimet retorike se Asociacioni do të pengonte punën e institucioneve të Kosovës kanë për qëllim parandalimin e formimit të Asociacionit. Për më tepër, konsiderohet se më me gjasë Qeveria e Kosovës do të mund ta pengonte punën e Asociacionit se anasjelltas.

Grupet e fokusit kanë treguar se ka dallime mes pjesëmarrësve nga veriu dhe jugu për sa i përket raportit që do të ekzistojë mes serbëve dhe Prishtinës në rast të formimit të Asociacionit të Komunave Serbe. Pjesëmarrësit në grupet e fokusit të mbajtura në Pomoravlje dhe Shtërpce shprehën pritjen se formimi i Asociacionit të Prishtinës do të kishte më pak ndikim te serbët. Në anën tjetër, pjesëmarrësit e grupeve të fokusit në Mitrovicën e Veriut besojnë se formimi i një Asociacioni do të nënkuptonte integrim të plotë të serbëve në sistemin e Kosovës.


5. Asociacioni i Komunave Serbe dhe pozita e serbëve të Kosovës

Një nga potencialet themelore të kësaj analize është që në diskutimin profesional dhe publik rreth Asociacionit të Komunave Serbe të futet perspektiva e serbëve të Kosovës, të cilës deri më tani nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme. Prandaj, analizës i ka paraprirë hulumtimi i gjerë empirik brenda komunitetit serb, në të cilin bazohet ky punim.

Konkluzioni kryesor që mund të nxirret nga analiza e kombinuar e intervistave dhe grupeve të fokusit të realizuara në kuadër të hulumtimit është se serbët në Kosovë nuk kanë ide të qartë se çfarë duhet të përfaqësojë Asociacioni i Komunave Serbe. Shtoja kësaj faktin se, siç theksojnë edhe vetë bashkëbiseduesit, në publik ka vetëm informata dhe shpjegime të pjesshme dhe të kufizuara, ata nuk e kanë të qartë se si do të organizohej Asociacioni, çfarë kompetencash do të kishte dhe si do të përfitonte komuniteti serb prej tij.

Opinionet dhe pritjet e pjesëmarrësve të grupeve të fokusit dhe intervistave në lidhje me efektet që do të kishte Asociacioni në përmirësimin e pozitës së serbëve janë të ndara. Disa prej tyre janë skeptikë dhe nuk presin shumë rezultate. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit përgjithësisht besojnë se Asociacioni nuk do të funksiononte mirë dhe nuk do të ishte veçanërisht efektiv, prandaj nuk presin që pas formimit të tij situata të ndryshojë ndjeshëm dhe të përmirësohen kushtet e jetesës së serbëve në Kosovë. Këndvështrim paksa më pozitiv karshi Asociacionit kanë disa bashkëbisedues në intervista. Ata besojnë se Asociacioni do të ishte i një rëndësie të madhe për serbët sepse do t'u mundësonte komunave me shumicë serbe të veprojnë së bashku në promovimin e interesave dhe të drejtave të komunitetit serb dhe të shërbente si adresë për komunikim me Beogradin.

Figura 4. A do të përmirësonte pozitën e komunitetit serb në Kosovë formimi i Asociacionit të Komunave Serbe (AKS)?



Rezultatet e sondazhit shpërfaqin pritje më optimiste nga Asociacioni i Komunave Serbe. Pyetjes nëse formimi i Asociacionit do të përmirësonte pozitën e serbëve të Kosovës, 20.4% e të anketuarve i janë përgjigjur se do ta përmirësonte shumë, ndërsa 43.8% u përgjigjën se do ta përmirësonte deri diku. Rezultati është i paraqitur në Figurën 4.

Për sa u përket fushave specifike me të cilat do të merrej Asociacioni, pjesëmarrësit e grupit të fokusit nga Anamorava shprehën pritshmërinë që formimi i tij të çojë në rritjen e numrit të vendeve të punës, uljen e emigrimit, si dhe investime më të mëdha në infrastrukturën rurale. Pjesëmarrësit e grupit të fokusit në Shtërpcë në mënyrë të ngjashme e lidhin formimin e Asociacionit me rritjen e numrit të vendeve të punës, si dhe me bashkëpunim më të madh mes enklavave, gjegjësisht përmirësimin e sigurisë dhe zvogëlimin e numrit të incidenteve.

Konkluzioni kryesor që mund të nxirret nga analiza e kombinuar e intervistave dhe grupeve të fokusit të realizuara në kuadër të hulumtimit është se serbët në Kosovë nuk kanë ide të qartë se çfarë duhet të përfaqësojë Asociacioni i Komunave Serbe.


Pritjet e shprehura në grupet e fokusit përkohë me rezultatet e anketës. Kur bëhet fjalë për fushat që do të ndikoheshin më shumë nga formimi i Asociacionit, 29,6% e të anketuarve janë përgjigjur se kjo do të ishte ekonomia. Fusha e dytë e veçuar ishte siguria, e cila u zgjodh nga 27% e të anketuarve, e ndjekur nga arsimi me 14,8%. Rezultati është i paraqitur në Figurën 5.

Të intervistuarit në mënyrë të ngjashme përmendin ekonominë si fushë në të cilën Asociacioni i Komunave Serbe mund të luajë rolin më të madh, dhe së këndejmi u tha se përmes Asociacionit do të realizohen projekte që do t'i kontribuojnë përmirësimit të gjendjes ekonomike në hapësirat serbe në Kosovë. Sipas bashkëbiseduesve, Asociacioni do t'u mundësonte serbëve të lidhen më shumë në ekonomi, arsim dhe shëndetësi, gjegjësisht të rrisin investimet në sistemin arsimor dhe shëndetësor.

Intervistat dhe grupet e fokusit tregojnë se ekziston një perceptim në mesin e pjesëtarëve të komunitetit serb se formimi i Asociacionit të Komunave Serbe do të çonte në mbylljen e institucioneve të mbetura të Serbisë në Kosovë. Bëhet fjalë për institucionet "e buta" në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe sigurisë sociale. Besohet se këto institucione do të integrohen në sistemin e Kosovës përmes Asociacionit, siç ishte rasti me policinë dhe gjyqësorin. Serbët që janë të punësuar aty do të kalonin në institucionet e Kosovës dhe kjo do të nënkuptonte ndërprerjen e prezencës institucionale të Serbisë në Kosovë.

Një pyetje e rëndësishme që u ngrit gjatë intervistave dhe grupeve të fokusit kishte të bënte me qëndrimin e serbëve që jetojnë jashtë komunave me shumicë serbe në rastin e formimit të Asociacionit të Komunave Serbe. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit dhe të intervistuarit pothuajse pajtohen në vlerësimin

Figura 5. Në cilën fushë do të pasqyrohej më pozitivisht formimi i Asociacionit të Komunave Serbe?



se, në rastin e formimit të Asociacionit, serbët që jetojnë jashtë komunave serbe do të përballëshin me sfida edhe më të mëdha. Sipas tyre, serbët në këto zona nuk do të kishin asnjë të drejtë, do të lireshin vetëm dhe do t'i ekspozoheshin marginalizimit dhe diskriminimit shtesë. U arrit në përfundim se kjo do të çonte në shpërnguljen e tyre. Prandaj gjatë intervistave u tha se duhet gjetur ndonjë mekanizëm për të lidhur serbët jashtë komunave serbe me Asociacionin.

Grupet e fokusit gjithashtu theksuan mendimet rreth peshës së ndryshme që do të kishte formimi i Asociacionit të Komunave Serbe për komunitetet serbe në veri dhe jug të Kosovës. Në grupin e fokusit në Graçanicë, u shpreh mendimi se për shkak të lidhjes territoriale të komuniteteve serbe, Asociacioni do të mund të funksiononte vetëm në veri të Kosovës. Komunitat në jug do të përfitonin më pak nga Asociacioni, sepse territori nuk është kompakt, por i fragmentuar. Për këto arsye, ata besojnë se nuk do të kishte përmirësim të jetës në zonat serbe në jug, por vetëm në komunitetet veriore, të cilat do të vazhdonin të zhvillohen në mënyrë disproporcionale në raport me jugun.

Në grupin e fokusit në Anamoravë u shpreh shqetësimi se në rast të formimit të Asociacionit të Komunave Serbe, veriu i Kosovës më lehtë do t'i bashkohej Serbisë. Në anën tjetër, grupi i fokusit në veri të Mitrovicës shprehu mendimin se nëse do të funksiononte Asociacioni me kompetenca ekzekutive ai do t'i kontribonte organizimit më të mirë të serbëve në Kosovë, gjegjësisht ndarja në serbë nga veriu dhe ata që jetojnë në jug të lbrit do te ishte me e vogel. U theksua, megjithatë, se në atë mënyrë veriu, i cili deri diku është autonom, do t'i bashkohej Kosovës dhe në atë rast Serbia do të kishte shumë më pak ndikim në situatën në Kosovë.



Në grupin e fokusit në Anamoravë u shpreh shqetësimi se në rast të formimit të Asociacionit të Komunave Serbe, veriu i Kosovës më lehtë do t'i bashkohej Serbisë. Në anën tjetër, grupi i fokusit në veri të Mitrovicës shprehu mendimin se nëse do të funksiononte Asociacioni me kompetenca ekzekutive ai do t'i kontribonte organizimit më të mirë të serbëve në Kosovë, gjegjësisht ndarja në serbë nga veriu dhe ata që jetojnë në jug të lbrit do te ishte me e vogel.

6. Shtjellimet përfundimtare

Asociacioni i Komunave Serbe prej vitesh ka qenë temë e debateve të nxehta politike mes Beogradit dhe Prishtinës. Polemika rreth Asociacionit ka rolin e vet në dinamikën e dialogut. Të dyja palët po e përdorin këtë çështje në mënyrë taktike për të forcuar pozitat e tyre negociuese dhe për të ndikuar në rrjedhën dhe agjendën e dialogut. Por, narrativat e pabaza për Asociacionin i kontribuojnë thellimit të antagonizmit ndërmjet palëve dhe cënimit e kushteve për dialog dhe zbatimin e marrëveshjeve të arritura.

Asociacioni i Komunave Serbe fillimisht ishte konceptuar si mekanizëm për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve për integrimin policor dhe gjyqësor dhe krijimin e komunave të reja në veri të Kosovës. Integrimi i katër komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës në sistemin e Kosovës ka qenë relativisht i suksesshëm, edhe pse Asociacioni nuk është formuar. Megjithatë, kjo nuk e eliminoi nevojën për formimin e tij.

Refuzimi eksplicit i obligimit për formimin e Asociacionit të Komunave Serbe nga lidershipi i Kosovës, me Albin Kurtin dhe Vjosa Osmanin, e bën të pakuptimtë rifillimin e dialogut. Arritja e marrëveshjeve të reja nuk duket e leverdishme nëse marrëveshjet aktuale nuk janë zbatuar dhe palët rezervojnë të drejtën të refuzojnë në mënyrë të njëanshme zotimet që kanë dhënë më parë. Refuzimi i Marrëveshjes për Asociacionin nuk përbën vetëm shkelje të dialogut, por edhe të sundimit të ligjit në Kosovë. Në vendimin e saj të vitit 2015, Gjykata Kushtetuese pa mëdyshje

gjeti se Asociacioni i Komunave Serbe është pjesë e rendit kushtetues të Kosovës në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar dhe se formimi i tij nuk është opsion por obligim.

Diskutimi rreth "modeleve të reja" të Asociacionit gjithashtu nuk përbën rrugëdalje nga kriza. Një qasje e tillë do të krijonte precedent që vë në pikëpyetje qëndrueshmërinë e të gjitha marrëveshjeve të tjera të arritura përmes dialogut. Kjo do të nënkuptonte se asnjë marrëveshje e arritur nuk është përfundimtare. Nëse marrëveshjet për Asociacionin të vitit 2013 dhe 2015, bëhen objekt rishikimi, dhe atë për shkak të tërheqjes së njërës palë nga detyrimet e saj, atëherë të gjitha marrëveshjet e tjera mund të rishikohen. Në këtë kuptim, integrimi i policisë dhe gjyqësorit nuk është domosdoshmërisht proces i pakthyesëm.

Çështja e Asociacionit të Komunave Serbe nuk mund të zgjidhet me një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës, sepse është një nga parakushtet kryesore që kjo të ndodhë. Për të krijuar kushtet për hapjen e dialogut për marrëveshjen përfundimtare, së pari është e nevojshme të zbatohen me mirëbesim të gjitha zotimet që janë dhënë më parë. Përndryshe, i tërë procesi do të përshkohet nga jokredibiliteti dhe paqëndrueshmëria. Nëse palët nuk tregojnë vullnet dhe përkushtim për zbatimin e marrëveshjeve të arritura më parë, nuk mund t'i besojnë njëra-tjetrës për zbatimin e marrëveshjeve të reja. Në këtë

drejtim, mosformimi i Asociacionit të Komunave Serbe është ndoshta forma më e vështirë e mosrespektimit të zotimeve të mëparshme në tërë procesin.

Për ta lëvizur çështjen nga ngërçi, duhet të rikthehet hartimi i Statutit të Asociacionit të Komunave Serbe dhe Dekretit të Qeverisë që do ta vërtetonte atë. Këto akte më pas duhet t'i dorëzohen Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, si dhe ekipeve negociuese në Bruksel. Përpara autorëve të Statutit dhe Rregullores është një detyrë e vështirë që të sigurojnë që këto akte njëkohësisht të jenë në përputhje Parimet e Përgjithshme dhe me Kushtetutën e Kosovës. Nëse shfaqet nevoja për nisjen e bisedimeve të reja për Asociacionin, ato mund të zhvillohen ekskluzivisht në bazë të tekstit të Statutit dhe Rregullores.

Frika se Asociacioni i Komunave Serbe mund të rrezikojë funksionalitetin e institucioneve në Kosovë nuk mund t'i referohet nivelit qendror të qeverisjes, por komunave. Nëse "kompetencat ekzekutive" të Asociacionit, gjegjësisht "mbikëqyrja e plotë" kuptohej si e drejta e Asociacionit për të modifikuar ose revokuar vendimet komunale ose për të marrë vendime që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në komuna, atëherë ekziston rreziku i mentorimit të Asociacionit kundrejt komunave. Kjo, megjithatë, është vërejtja që më shumë mund ta bëjnë komunat ndaj Asociacionit, sesa pushteti qendror. Megjithatë, kjo nuk duhet të ishte arsye që Asociacioni të mos formohet, por një rrezik që duhet pasur parasysh gjatë hartimit të Statutit.

Formimi i Asociacionit të Komunave Serbe, si kornizë për bashkëpunimin dhe lidhjen e komunave me shumicë serbe, duket i leverdishëm duke pasur parasysh se komunitetet serbe në Kosovë përbëjnë një tërësi të veçantë sociale, kulturore dhe ekonomike. Mes zonave serbe në Kosovë po ndodh lëvizshmëria e qytetarëve me qëllim të punësimit dhe arritjes së bashkëpunimit afarist, si dhe për plotësimin e nevojave arsimore dhe shëndetësore. Pjesëtarët e komunitetit

serb nga komunat më të vogla dërgohen, për trajtim, në komunat ku ka qendra më të mëdha shëndetësore, nxënësit dhe studentët lëvizin nga një komunë me shumicë serbe në tjetrën për të ndjekur arsimin e mesëm ose universitar, ose për të marrë pjesë në takime shkollore, gara, e kështu me radhë.

Njohja e ndërsjellë e hapësirave serbe në Kosovë e bën të domosdoshëm zhvillimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit dhe partneritetit mes komunave me shumicë serbe. Këtij qëllimi do të duhej t'i kontribonte edhe Asociacioni i Komunave Serbe. Komuniteti gjithashtu do të mund të shërbente si mekanizëm për menaxhimin e investimeve dhe projekteve ekonomike dhe infrastrukturore që përfshijnë më shumë komuna me shumicë serbe, duke nxitur kështu integrimin ekonomik dhe fuqizimin e komuniteteve serbe në Kosovë.

Për të siguruar mbështetje më të madhe publike për këto procese, të dyja palët duhet të përpiqen të informojnë qartë dhe saktë komunitetet e tyre për përmbajtjen reale të marrëveshjeve të arritura. Ndërsa Prishtina duhet të heqë dorë nga narrativa që e paraqet formimin e Asociacionit të Komunave Serbe si "boshnjakizim" të Kosovës, pala serbe, përkatësisht Beogradi dhe përfaqësuesit politikë serbë në Kosovë, duhet t'i shpjegojnë komunitetit serb se çfarë përfitimesh do të kishte nga formimi i Asociacionit.

Te komuniteti serb në Kosovë ekzistojnë shqetësime se formimi i Asociacionit të Komunave Serbe do të çonte në shfuqizimin e institucioneve "të buta" serbe në Kosovë, gjegjësisht integrimin e tyre në sistemin e Kosovës. Vështrimi i tillë ka të ngjarë të ketë lidhje me kompetencat e Asociacionit në fushën e shëndetësisë dhe arsimit. Megjithatë, asnjë marrëveshje për Asociacionin nuk parasheh në mënyrë eksplicite integrimin e këtyre institucioneve në sistemin e Kosovës, siç ishte rasti me Marrëveshjen e Brukselit për Integrimin e Policisë dhe Gjyqësorit.

Për të hequr dyshimet e serbëve në Kosovë, përfaqësuesit politikë serbë duhet të shprehin qartë nëse formimi i Asociacionit të Komunave Serbe është koncesion nga ana e Prishtinës në këmbim të integritit të institucioneve “të buta” serbe në sistemin e Kosovës. Çështja tjetër, së cilës duhet t’i përgjigjet pala serbe, ka të bëjë me serbët që jetojnë jashtë komunave me shumicë serbe. Pozicioni i serbëve që do të ishin jashtë territorit që mbulon Asociacioni i Komunave Serbe është një çështje për të cilën Beogradi dhe politikanët serbë në Kosovë ende nuk kanë folur. Nëse me rastin e formimit të Asociacionit nuk i kushtohet vëmendje adekuate serbëve jashtë komunave serbe, ekziston frika se kjo mund të nxisë shpërnguljen e tyre.

Çështja e serbëve jashtë komunave serbe tregon se Asociacioni i Komunave Serbe është i rëndësishëm, por jo i vetmi mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komunitetit serb në Kosovë. Në Parimet e Përgjithshme thuhet se Asociacioni i Komunave Serbe do të marrë masa “për përmirësimin e kushteve të jetesës së të kthyerve në Kosovë”. Në këtë aspekt, duhet sjellë ndërmend se kthimi i serbëve nuk ka ndodhur asnjëherë në zona më të mëdha urbane si në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj e të tjera. Asociacioni i Komunave Serbe nuk do të kishte kompetencë për të krijuar kushte për kthimin e serbëve të zhvendosur në këto komuna. Kjo duhet të shërbejë si kujtesë se puna për përmirësimin e pozitës së komunitetit serb në Kosovë duhet të vazhdojë edhe pas formimit të Asociacionit të Komunave Serbe.



Frika se Asociacioni i Komunave Serbe mund të rrezikojë funksionalitetin e institucioneve në Kosovë nuk mund t’i referohet nivelit qendror të qeverisjes, por komunave. Nëse “kompetencat ekzekutive” të Asociacionit, gjegjësisht “mbikëqyrja e plotë” kuptohet si e drejta e Asociacionit për të modifikuar ose revokuar vendimet komunale ose për të marrë vendime që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në komuna, atëherë ekziston rreziku i mentorimit të Asociacionit kundrejt komunave.

7. Rekomandime

Për Prishtinën

Të ndërmarrë hapa pa vonesë për formimin e Asociacionit të Komunave Serbe për të demonstruar përkushtim për zbatimin e zotimeve të mëparshme.

Ta vendosë dialogun në pozitë më të lartë në listën e prioritetëve dhe të tregojë vullnet më të madh politik për të zgjidhur çështjet e hapura në mënyrë konstruktive.

Të informojë saktësisht dhe plotësisht opinionin për përmbajtjen e marrëveshjeve të arritura dhe të përmbahet nga retorika e ashpër që krijon armiqësi mes komuniteteve në Kosovë.

Për Beogradin

T'i informojë serbët në Kosovë për rëndësinë që do të kishte Asociacioni i Komunave Serbe për pozitën e tyre, si dhe për synimet lidhur me statusin e institucioneve shëndetësore, arsimore dhe sociale serbe.

Të këmbëngulë në përmbushjen e zotimeve të dhëna më parë, me theks të veçantë në formimin e Asociacionit të Komunave Serbe, si parakusht për vazhdimin e dialogut dhe arritjen e marrëveshjeve të reja.

T'u kushtojë vëmendje serbëve të Kosovës që jetojnë jashtë komunave me shumicë serbe dhe të tregojë përkushtim për të gjetur dhe avokuar për zgjidhje pozitive për të përmirësuar pozitën e tyre.

Për Brukselin

T'i kërkojë Beogradit dhe Prishtinës të tregojnë progres në zbatimin e zotimeve të mëparshme përpara se të arrijnë marrëveshje të reja.

Të rikonfirmojë përkushtimin ndaj formatit ekzistues të dialogut, i cili përfshin përfundimin e marrëveshjeve të arritura dhe detyrimin për të zbatuar marrëveshjet e mëparshme.

Të përkushtohet që procesi i formimit të Asociacionit të Komunave Serbe të fillojë para se të hapet dialogu për një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

